



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A. DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DREJTORIA E PROKURIMEVE



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “FUSHA”sh.p.k, me NIPT J61922018S, me seli në Adresën: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballë Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Asfaltimi i objekteve të investimeve dhe mirëmbajtjes së rrjetit UKT sha”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-76936-06-28-2018

Fondi limit: 14.885.745 (katërmëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës

Data e zhvillimit të tenderit është: 06.08.2018, 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.26 të dates 02.07.2018

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “A.L-ASFALT” sh.p.k.

K81511508A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

2. Operatori Ekonomik “VARAKU E” sh.p.k

J61902509S

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 9.450.000 (nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” sh.a.

K01730502W

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 11.124.750 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

4. Operatori Ekonomik “FUSHA” sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **13.147.050** (trembëdhjetë milion e njëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

J61922018S

numri i NIPT-it

Janë skualifikuar operatorët ekonomik për arsyet si më poshtë vijon:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “A.L-ASFALT” sh.p.k me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**A.L-ASFALT**” **sh.p.k** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12 gjithashtu nuk ka paraqitur ofertën ekonomik me preventivin bashkëlidhur të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**A.L-ASFALT**” **sh.p.k** s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur ofertën ekonomike sipas shtojcës 1 , të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit për këtë procedurë.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.a.me vlerë të ofertës 11.124.750 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy)	2 cope	Pronësi ose me qera

ton për secilin kamionçinë		
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	2 cope	Pronësi ose me qera
Makineri fshese me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Makineri sperkatje bitumi	1 cope	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pjate vibruese	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

- 1. Kamioncinë me targa DR9043D me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.7Ton(do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 1.5 ton dhe max 2 T)***
- 2. Kamioncinë me targa AA638KT me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.8 Ton***

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamionçinë** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm një kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton për secilën kamionçinë të kërkuar nga AK (2 cope) , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “VARAKU E” sh.p.k me vlerë të ofertës 9.450.000 (nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e

rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	2 cope	Pronësi ose me qera
Makineri fshese me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Makineri sperkatje bitumi	1 cope	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pjate vibruese	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “VARAKU E” në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

1. *Kamioncinë me targa AA892SZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.8 Ton*
2. *Kamioncinë me targa DR9451D me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)*

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamionçina ka paraqitur vetëm një kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton

për secilin kamion te kerkuar nga AK (2 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit është kërkuar si më poshtë:*

d.Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit KVO konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë formular vlerësimi sipas shtojcës 9 çka bie në kundërshtim me kriteret e kërkuara në DST.

Përsa më sipër mungesa e dokumentacionit përbën kusht për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**FUSHA**” sh.p.k, me NIPT J61922018S, me seli në Adresën: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballe Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja, Tiranë, me ofertë ekonomike me vlerë prej **13.147.050** (trembëdhjetë milion e njëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, se është **identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.08.2018.

Ankesa: Nuk ka